



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.109/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova Kryesuese, Hajriz Hoti, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik GI Novo Lice – Narodna Pravda, me seli në Mitrovicën e Veriut, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 08.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik GI Novo Lice – Narodna Pravda, me seli në Mitrovicën e Veriut, ZL.Anr.109/2025, ZL.Anr.110/2025, ZL.Anr.111/2025, ZL.Anr.112/2025, ZL.Anr.113/2025, ZL.Anr.114/2025, ZL.Anr.115/2025, ZL.Anr.116/2025, ZL.Anr.117/2025, ZL.Anr.118/2025, ZL.Anr.120/2025, të datës 06.10.2025, kundër Subjektit Politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

II. Subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 6,000.00 (gjashtëmijë) euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet subjekti politik Lista Serbe, që nga momenti i marrjes së këtij vendimi t'i largoj posteret në vendet përgjatë rrugës kryesore Mitrovicë – Jarinje, stacionin e autobusit në lokalitetin Jezero, hapësirat publike - parqet në rrugën "Vojske Jugosllavije", në mbikalimin në hyrje të Leshakut, në komunën e Leposaviqit, në vendin Soçanicë, në rrugën kryesore Leshak-Leposaviç, në trafo-stacion (në afërsi të kishës dhe zhitoproduktit).

Arsyetim

Me datë 06.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.109/2025, ZL.Anr.110/2025, ZL.Anr.111/2025, ZL.Anr.112/2025, ZL.Anr.113/2025, ZL.Anr.114/2025, ZL.Anr.115/2025, ZL.Anr.116/2025, ZL.Anr.117/2025, ZL.Anr.118/2025, ZL.Anr.119/2025, ZL.Anr.120/2025, të datës 06.10.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik GI Novo Lice – Narodna Pravda, ku në ankesën ZL.Anr.109/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" kanë vërejtur se subjekti politik Lista Serbe në Komunën e Leposaviqit, në një shtyllë elektrike dhe në stacionin e autobusit në lokalitetin Jezero, përgjatë rrugës kryesore Mitrovicë - Jarinje (një vend i njohur me emrin Stražara), kanë ngjitur materialin e tyre promovues, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore nr. 7/2024.

Në ankesën ZL.Anr.110/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë kishin ngjitur materialin e tyre promovues në dy shtylla elektrike përgjatë rrugës magjistrale Mitrovicë-Jarinj, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.111/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë kishin ngjitur materialin e tyre promovues në shtyllat elektrike dhe në hapësirat publike - parqet në rrugën "Vojske Jugosllavije", duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.112/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë kishin ngjitur materialin e tyre promovues në një hapësirë publike, në mbikalimin në hyrje të Leshakut, në një shtyllë elektrike dhe në barrierat metalike (bankinat), duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.113/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë, në vendin Soçanicë, kishin ngjitur materialin e tyre promovues në trafo-stacion, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.114/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë, në vendin Soçanicë, kishin ngjitur materialin e tyre promovues në murin mbështetës përgjatë rrugës magjistrale Jarinjë-Mitrovicë, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr. 07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.115/2025, pretendohet se me datë datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" vunë re se subjekti politik Lista Serb në komunën e Leposaviqit, në fshatin Socanica, në stacionin e autobusit në përgjatë rrugës kryesore Mitrovicë - Jarinje, kanë ngjitur materialin e tyre promovues, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.116/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë, në rrugën "Braće Matović" në Lešak, kishin ngjitur materialin e tyre promovues në një objekt hekurudhor, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.117/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Mitrovicës Veriore, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë, në fshatin Dren, në kryqëzimin për Belo Brdo, kishin ngjitur materialin e tyre promovues në një objekt në pronësi të Agjencisë për Privatizim, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.118/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë kishin ngjitur materialin e tyre promovues në stacionin e autobusëve në rrugën kryesore Leshak-Leposaviç, duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024.

Në ankesën ZL.Anr.120/2025, pretendohet se me datë 05.10.2025, aktivistët e GI "Novo Lice - Narodna Pravda" në komunën e Leposaviqit, vunë re se subjekti politik Lista Serb në këtë komunë, kishin ngjitur materialin e tyre promovues në trafo-stacion (në afërsi të kishës dhe zhitoproduktit), duke shkelur kështu Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024. Ankesave të parashtruara ankuesi ka bashkangjitur foto si dëshmi.

Në përgjigje në ankesat ZL.Anr.109/2025, ZL.Anr.110/2025, ZL.Anr.111/2025, ZL.Anr.112/2025, ZL.Anr.113/2025, ZL.Anr.114/2025, ZL.Anr.115/2025, ZL.Anr.118/2025, 120/2025, subjekti politik Lista Serbe thekson se në ankesat e parashtruara, me të cilat pretendon se përkrahësit e subjektit politik Lista Serbe, kishin vendosur material promocional në disa lokacione në komunën e Leposaviqit dhe kështu shkelën Rregullat Zgjedhore në lidhje me vendosjen e materialit promocional të Listes Serbe në territorin e komunës së Leposaviqit, dëshirojmë të theksojmë se kjo ankesë është paraqitur jashtë afatit, sepse i njëjti material është vënë re nga aktivistët e subjektit politik GI Za slobodu i pravdu i opstanak dhe Nenad Rašić paraqiti në ankesën nr. 81 në të cilën pretendonte se materiali u vërejt më 21.09.2025. PZAP në lidhje me atë ankesë ka vendosur më 01.10.2025, dhe i hodhi poshtë si të paraqitura jashtë afatit.

Duke pasur parasysh sa më sipër, bashkëngjitim si shtojcë vendimin e PZAP-së, me të cilin vërtetohet se materiali i përmendur ishte vendosur shumë më parë dhe se ankesat e përmendura ZL.Anr.109/2025, ZL.Anr.110/2025, ZL.Anr.111/2025, ZL.Anr.112/2025, ZL.Anr.113/2025, ZL.Anr.114/2025, ZL.Anr.115/2025, ZL.Anr.118/2025, 120/2025, janë jashtë afatit.

Ndërsa në raport me ankesat ZL.Anr.116 dhe ZL.Anr.117/2025, është theksuar se menjëherë pasi janë informuar se është paraqit ankesë kanë ndërmarr masa korrigjuese dhe kanë hoqur materialin e përmendur. Për çka si dëshmi kanë paraqitur dëshmi fotografitë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, se si subjekt politik përgjegjës kemi hequr materialin promocional të përmendur në përputhje me Rregulloren Zgjedhore NR. 1/2025, nenin 11 i cili thotë: "Para shpalljes së dënimit, PZAP mund të kërkojë nga pala kundër së cilës është paraqitur ankesa që ajo të ndërmarrë masa korrigjuese për heqjen e shkeljes brenda një afati që cakton PZAP. Urdhëri për heqjen e shkeljes ka për qëllim t'i japë palës mundësinë të heqë ose të reduktojë shkeljen para se PZAP të marrë vendim."

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.Anr.109/2025, ZL.Anr.110/2025, ZL.Anr.111/2025, ZL.Anr.112/2025, ZL.Anr.113/2025, ZL.Anr.114/2025, ZL.Anr.115/2025, ZL.Anr.116/2025, ZL.Anr.117/2025, ZL.Anr.118/2025, ZL.Anr.120/2025, të datës 06.10.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZL.A.nr.109/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

PZAP, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vlerësoi se:

- Ankesat janë bazuara

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndëve përkatësisht ankesave: ZL.Anr.109/2025, ZL.Anr.110/2025, ZL.Anr.111/2025, ZL.Anr.112/2025, ZL.Anr.113/2025, ZL.Anr.114/2025, ZL.Anr.115/2025, ZL.Anr.118/2025, 120/2025, dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Lista Serbe, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik GI Novo Lice Narodna Pravda, janë të qëndrueshme dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesat e parashtruara, paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Lista Serbe, kjo pasi që ky subjekt politik ka vendosur material promovues në hapësira publike (shtylla elektrike, parqe, stacion të autobusit, mbikalim, trafo-stacion, rruge publike, objekt hekurudhor, objekt në pronësi të Agjencisë për Privatizim), andaj me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve."*

Subjekti Politik Lista Serbe ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësitë gjatë procesit të fushatës zgjedhore, andaj vendosja e materialit promovues në fushatë zgjedhore pa lejen e organeve kompetente, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, të cilat shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Në raport me ankesat me numër ZL.Anr.116/2025 dhe ZL.Anr.117/2025, paneli vlerëson se subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të rregullave zgjedhore të sipërcituara me vendosjen e

materialit promovues, dhe fakti që këto material janë larguar nuk e liron nga përgjegjësia për shkeljen e bërë, por në lartësinë e gjobës së shqiptuar si rrethanë lehtësuese ka marr faktin se është larguar materiali promovues nga vendi i kontestuar, që tregon se është bërë përpjekje serioze për eliminimin e shkeljes së bërë. Ndërsa për këtë rast është vendos sipas praktikës së ndërtuar tashmë nga PZAP-it, ku për raste të ngjashme është vendosur në këtë mënyrë.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik në fjalë ka pretenduar se këto raste janë të pasafatshme, me pretendim se për vendosjen e materialit në fjalë subjekti politik ankues ka qenë në dijeni më herët, duke ju referuar rastit Z.L.nr.81/2028, pjesë e vendimit të panelit ZI.nr.79/2025, datë 01.10.2025. Paneli ka shqyrtuar këto pretendime duke analizuar edhe rastin që është marrë si referencë, mirëpo sipas panelit pretendimi i tillë është i pathemeltë kjo pasi që afatshmeria e këtyre ankesave nuk mund të ndërlidhet me rastin Z.L.nr.81/2028, kjo pasi që në këtë rast subjekti ankues është subjekti politik Za Slobodu, Pravdui Opstanak- Nenad Rashiq, ndërsa në këto ankesa subjekti ankues është subjektit politik GI Novo Lice – Narodna Pravda. Pra nuk mund të vlerësohet afatshmeria e këtyre ankesave duke ju referuar ankesës së një subjekti tjetër, por afatshmeria lidhet me subjektin ankues kur e ka identifikuar shkeljen e pretenduar. Mbi këtë bazë është vlerësuar i pathemeltë pretendimi se ankesat janë të pasafatshme.

Duhet pas parasysh se në këtë vendim janë përfshi 12 ankesa, ndërsa lartësia e dënimit i përgjigjet natyrës së shkeljes dhe praktikës së ndjekur nga paneli për raste të tilla. Me rastin e shqiptimit të gjobës paneli ka vlerësuar edhe ankesat me numër ZL.Anr.116/2025 dhe ZL.Anr.117/2025, përkatësisht veprimet që ka ndërmarr ky subjekt në e shkeljes. Pra, paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, përkatësisht faktin se i njëjti subjekt në këtë fushatë zgjedhore është dënuar edhe më parë për shkelje të natyrës se tillë dhe me këto veprime i njëjti ka përsëritur shkeljet, e si rrethane lehtësuese janë marr parasysh veprimet që ka ndërmarr në eliminimin e disa prej shkeljeve.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse shkelja ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod, me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës, demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Andaj, veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën siç është cek me lartë e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.109/2025 më datën 08.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Hushi Rugova



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.